REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 3083 Prot.

Vlorë, më 16/10/2026

VENDIM

"Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë".

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.182, me Nr.1479/5 Prot., datë 28/08/2026, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 20,000 (Njëzetë mijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, me seli në Vlorë (Fshati Fitore, Objekti Nr.69, Novoselë, E-Mail: unionmarine.shpk@gmail.com), me status në QKB "Aktiv". Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.1479/6 Prot., datë 02/09/2026, me lëndë "Njoftim Vendimi", por rezulton se zarfi me kod bar RR865144385AA është rikthyer në doganë me shënimin postar "LARGUAR". Më tej, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me kryerjen e lajmërimit (njoftimit) publik me shkresat :

Nr.2741 Prot., datë 15/09/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer afishimin me shkresën nr.17783 Prot., datë 17/09/2026;

Nr.2742 Prot., datë 15/09/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e tij nr.1176/1 Prot., datë 12/09/2026, me lëndë "Mbi shpalljen publike të aktit administrativ", e cila është administruar në doganë me nr.2742/1 Prot., datë 23/09/2026;

Nr.2743 Prot., datë 15/09/2026, me "*Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)*", drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e saj nr.18754/1 Prot., datë 21/09/2026, me lëndë "Mbi kërkesën për konfirmim të shpalljes publike", e cila është administruar në doganë me nr.2743/1 Prot., datë 23/09/2026;

Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 15/09/2026, ora 11:55, me lëndë "Njoftim Vendimi (akti administrativ Nr.182, me nr.1479.5 Prot., datë 28/08/2026". Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.2875 Prot., datë

30/09/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcituar. Personi juridik debitor "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.182, me Nr.1479/5 Prot., datë 28/08/2026, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.182, me Nr.1479/5 Prot., datë 28/08/2026, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*,

V E N D O S A :

• Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "Union Marine" sh.p.k, me NIPT M16328202S, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 20,000 (Njëzetë mijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.182, me Nr.1479/5 Prot., datë 28/08/2026, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj